



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 260, Datë 17.12.2018

MBI

PRANIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ROBERTO OIL” SH.A., PËR HEQJEN E LICENCËS SË VEPRIMTARISË SË FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të nenit 16, nenit 42 pika 1, gërma “dh” e Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 5 gërma “dh”, nenit 7, paragrafi 2 dhe nenit 9, gërma “d”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 58, datë 18.04.2017, nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.12.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi kërkesën e shoqërisë “Roberto OIL” sh.a për heqjen e licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike

Konstatoi se :

- ERE me Vendim të Bordit të Komisionerëve nr. 50, datë 17.04.2015, ka licencuar shoqërinë “Roberto OIL” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike
- Shoqëria “Roberto OIL” sh.a., me email-in e datës 13.11.2018, protokolluar në ERE, me nr. 727 Prot, datë 13.11.2018, ka kërkuar revokimin e licencës pasi nuk ushtron aktivitetin tregtar, për të cilën është licencuar nga Enti Rregullator i Energjisë.
- ERE me shkresën nr.722/1 Prot, datë 21.11.2018, i është drejtuar shoqërisë “Roberto OIL” sh.a., ku i ka kërkuar saktësimin e objektit të kërimit, duke qënë se nga përmbajtja e email nuk del e qartë se cilën nga licencat kërkoni të hiqet, pasi subjekti disponon dy licenca, si dhe ka kërkuar paraqitjen e vendimit të miratuar nga organet drejtuese të shoqërisë, për heqjen e licencave respektive.
- Shoqëria “Roberto OIL” sh.a. me email-in e datës 03.12.2018, protokolluar në ERE me nr. 722/2 Prot., datë 03.12.2018, ka përcjellë vendimin nr. 5 Prot, datë 09.11.2018, e ortakut të vetëm të shoqërisë, dhe licencën e furnizimit të energjisë elektrike me nr. 279, Seria FK15, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 50, datë 17.04.2015.
- Shoqëria “Roberto OIL” sh.a. ka kryer pagesën e rregullimit, për vitet 2015; 2016; 2017, në pajtim me pikën 6 të kushteve të Licencës, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Kërkesa për heqje të licencës sipërcituar, vjen si rezultat i mos ushtrimit të veprimtarisë, për të cilën është licencuar shoqëria “Roberto OIL” sh.a. dhe i drejtohet ERE-s nën vullnetin e saj të plotë.
- Kërkesa e shoqërisë “ROBERTO OIL” sh.a, për heqjen e licencës së furnizimit vjen në zbatim të nenit 42, pika 1, gërma “dh”, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, në të cilin citohet se: *ERE heq një licencë me kërkesë të të licencuarit*; si dhe nenit 5, gërma “dh” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin nr. 58, datë 18.04.2017, të Bordit të ERE.
- Po ashtu në paragrafin 2, të nenit 7 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, përcaktohet se: *“Në rast se i licencuari është propozuar për t’iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat “dh” dhe/ose “e” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9 të kësaj rregulloreje.”*
- Neni 9 “Vendimet e Bordit”, i kësaj rregullore në gërmën “d” të saj, përcakton se: *“...Bordi do të vendosë për të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat “dh” dhe / ose “e” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 7 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje.”*

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “ROBERTO OIL” sh.a., për heqjen e licencës së furnizimit me energji elektrike me nr. 279 Seria FK15, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 50, datë 14.11.2015.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi licenca e sipërcituar humbetfuqinë e saj juridike.
3. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s..

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI